

638  
15.2.24

**BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A.**

Nr. 69/1 Prot.

Tiranë, më 13.02. 2024

**Lënda:** Mbi miratimin e Procedurës së Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a.

**ENTIT RREGULATOR TË ENERGJISË**

Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimi", Nr. 1023, Tirana.

Inderuar Z. Ahmeti,

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarrja, në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022 2022 dhe në cilësinë e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 228, datë 17.07.2023, për zonën ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës, duke pasur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e këtij funksioni, paraqet para Jush për miratim Procedurën e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a.

Në vijim të Vendimit Nr. 347, datë 27.12.2022 "Për miratimin e Rregullave të tregut të energjisë elektrike (Rregullat e ALPEX Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)" të ndryshuar, duke u bazuar në parashikimin e paragrafit B.2.1.5, gërmë c) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e përgjithshme, ALPEX Ju përcjell Procedurën e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a, të punuar në gjuhën shqipe.

Për hartimin e kësaj Procedure janë marrë në konsideratë të gjitha parashikimet Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, si dhe parashikimet e Procedurave të Komitetit të Bursave Evropiane të energjisë elektrike, në mënyrë që Procedura e Komitetit të Bursës ALPEX të bazohet në eksperiencën e Bursave Europiane të Energjisë dhe të bëjë të mundur promovimin e objektivit të ALPEX sh.a.

Kjo Procedurë, do të dërgohet për miratim në të njëjtin standard edhe pranë Zyrës së Rregulatorit për Energji të Republikës së Kosovës.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm përsa më sipër.

Me respekt,

**ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a**

Sokol Dishnica





**ALPEX**  
Albanian Power Exchange

**BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE**

**PROCEDURA E KOMITETIT TË BURSËS**

## Contents

A.	HYRJE.....	4
A.1	QËLLIMI .....	4
A.1.1	Procedura e Komitetit të Bursës .....	4
A.1.2	Baza ligjore e kësaj Procedure .....	4
A.1.3	Modifikimet në Procedurë .....	4
A.1.4	Pajtueshmëria me Procedurat .....	4
A.1.5	Roli i Autoriteteve Rregullatore .....	5
A.2	ANËTARËT E KOMITETIT NË FUNKSION Të PROMOVIMIT Të OBJEKTIVAVE .....	5
A.3	PËRMBLEDHJE E KËSAJ PROCEDURE.....	5
A.3.1	Përbajtja.....	5
A.3.2	Përkufizimet .....	5
B.	FORMAT E KËSHILLIMIT .....	6
B.1	UDHËRRËFYESI .....	6
B.1.1.1	ALPEX-i mund të zhvillojë dhe publikojë udhërrëfyes për gjitha llojet e vendimeve, rekondimeve dhe raporteve të Komitetit të Bursës, në lidhje me:.....	6
C.	KOMITETI I BURSËS .....	7
C.1	KËRKESAT PËR ANËTARËSIM.....	7
C.1.1	Numri i Anëtarëve.....	7
C.1.2	Emërimet e kryetarit dhe zëvëndëskryetarit .....	7
C.1.3	Kategoritë e anëtarëve dhe vëzhguesve.....	7
C.1.4	Larmishmëria e përfaqësimit të palëve të interesit .....	7
C.1.5	Kualifikimi i anëtarëve .....	7
C.1.6	Anëtarët do të veprojnë në ndihmë të arritjes së Objektivave të ALPEX-it .....	8
D.	MBLEDHJET E KOMITETIT TË BURSËS .....	9
D.1	PLANIFIKIMI I MBLEDHJEVE .....	9
D.1.1	Frekuenca e mbledhjeve.....	9
D.1.2	Njoftim i mbledhjeve .....	9
D.1.2.1	ALPEX-i do të:.....	9
D.1.2.2	Përpara çdo mbledhje të Komitetit të Bursës: .....	9
D.2	ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE .....	9
D.2.1	Kuorumi.....	9
D.2.2	Pjesëmarrja e vëzhguesve.....	9

D.2.3	Vendimet dhe votimi .....	10
D.2.4	Procesverbali.....	10
E.	PËRBËRJA E KOMITETIT TË BURSËS.....	11
E.1.1	FILLIMI I KOMITETIT TË BURSËS.....	11
E.1.1.1	Autoriteti Rregulator mund të emërojë një vëzhgues i cili do të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Bursës duke i dërguar një kërkesë me shkrim ALPEX-it. ....	11
E.1.2	Anëtarët në fillimin e Komitetit të Bursës .....	11
E.1.2.1	Në mënyrë që ta ndihmojë tregun, në fillim Komiteti i Bursës të përbëhet nga: .....	11
(a)	Një minimum prej katër (4) anëtarësh të zgjedhur: .....	11
(i)	Për të reflektuar larmishmërinë e Anëtarëve të Bursës siç parashikohet në seksionin C.1.4 të kësaj Procedure; dhe .....	11
(ii)	Të përzgjedhur nga personat e propozuar me shkrim dhe drejtuar Sekretariatit prej Anëtarëve potencial të Bursës; dhe .....	11
(b)	Të paktën dy anëtarë të tjera të cilët emërohen nga ALPEX, ku njëri prej tyre do të jetë Kryetari. 11	
E.1.2.2	Afati i një emërim i bërë sipas paragrafit E.1.2.1(a) të kësaj Procedure mbaron sipas afateve të parashikuara ose kur emërimet jane bërë sipas kapitullit C të kësaj Procedure cilaqoftë e para. ....	11
E.1.2.3	Subjekt i paragrafit F.3.1.2 të kësaj Procedure, një anëtar i Komitetit të Bursës i emëruar sipas paragrafit E.1.2.1(a) të kësaj Procedure mund të ndiqet nga rizgjidhja sipas Kapitullit F të kësaj Procedure.....	11
E.1.3	Koha për emërimet e rradhës.....	11
E.1.3.1	Në takimin e parë, Komiteti i Bursës do të vendosi lidhur me emërimet e Anëtarëve të Bursës sipas Kapitullit F të kësaj Procedure. ....	11
F.	AKTIVITETET E MËTEJSHME TË KOMITETIT TË BURSËS .....	12
F.1	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	12
F.1.1	Zbatimet i këtij Kapitulli .....	12
F.1.2	Administrimi i Zgjedhjeve të Komitetit .....	12
F.1.3	Autoriteti për të bërë emërime dhe zgjedhjet .....	12
F.2	PROCEDURAT ZGJEDHORE.....	12
F.2.1	Njoftimi i vendeve vakante .....	12
F.2.2	Propozimet.....	13
F.2.3	Mënyra e perzgjedhjes së Anëtarit kur vendet e lira tejkalojnë propozimet .....	13
F.2.4	Zgjedhjet kur propozimet tejkalojnë vendet vakante. ....	13
F.2.5	Përcaktimi dhe publikimi i rezultateve .....	14
F.3	AFATI I EMËRIMIT .....	15

F.4	DORËHEQJA DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KOMITETIT TË BURSËS .....	15
F.4.1	Shkarkimi nga Komiteti i Bursës.....	15
F.4.2	Dorëheqja .....	15
F.4.2.1	Një anëtar mund të japë dorëheqjen duke i dhënë të paktën dy javë përpara njoftim me shkrim kryetarit të Komitetit të Bursës. ....	15
G.	PROCEDURAT E PROPOZIMEVE PËR MODIFIKIM .....	16
G.1	HISTORIKU.....	16
G.1.1	Burimet e Propozimeve për Modifikim .....	16
G.1.2	Qëllimi i këtij Kapitulli .....	16
G.1.3	Propozimet e modifikimit të iniciuara nga Komiteti i Bursës .....	16
G.2	PARIMET/QASJA.....	16
G.2.1	Këshilla në kohë .....	16
G.2.2	Paraqitja me saktësi e pikëpamjeve .....	16
G.3	AFATET KOHORE PËR KONSIDERIMIN E PROPOZIMEVE PËR MODIFIKIM .....	17
G.3.1	Hapat paraprak nga ALPEX-i .....	17
G.3.2	Njoftimi i propozimeve për Modifikim .....	17
G.3.3	Propozimet urgjente për Modifikim .....	17
G.3.4	Procesi i përshtypetuar për ndryshime të thjeshta .....	18
G.3.5	Procedura për zhvillimin e rekomandimeve dhe raporteve .....	18
G.3.6	Afati kohor i raportimit .....	18
G.3.7	Propozimet Alternative .....	19
G.3.8	Shqyrtimi dhe votimi i Komitetit të Bursës mbi Propozimet për Modifikimit .....	19
G.3.9	Raportimi .....	20
G.4	Vendim i ALPEX .....	20
H.	NJOFTIMET.....	21
H.1	NJOFTIMET E KOMITETIT TË BURSËS .....	21
H.2	PËRFAQËSUESI I ANËTARIT TË BURSËS .....	21
H.3	DËRGIMI I NJOFTIMEVE .....	21
I.	SEKRETARIATI.....	23
I.1	DETÝRAT.....	23
I.2	MBLEDHJET .....	24

---

## A. HYRJE

---

### A.1 QËLLIMI

#### A.1.1 Procedura e Komitetit të Bursës

- A.1.1.1 Ky dokument përcakton procedurat e detajuara për Komitetin e Bursës të krijuar sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.
- A.1.1.2 Kjo Procedurë i mundëson Komitetit të Bursës të kryejë rolin dhe funksionet e tij në promovimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat që të mbeten aktuale dhe të përditësuara me kalimin e kohës, nëpërmjet konsultimit dhe këshillimit me ALPEX-in për ndryshimet e propozuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.

#### A.1.2 Baza ligjore e kësaj Procedure

- A.1.2.1 Kjo Procedurë është pergatitur në mbështetje të seksionit B.3.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.
- A.1.2.2 Përbajtja e kësaj Procedure mbështetet në dispozitat e:
- (a) Seksionit B.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, përsa i përket Komitetit të Bursës që përcaktojnë:
    - (i) Rolin dhe funksionin e tij
    - (ii) Perbërjen e tij
    - (iii) Zgjedhjen për kryetarin dhe zëvendëskryetarin
    - (iv) Kërkesat për mbledhjet
    - (v) Dakordësinë mbi kostot
    - (vi) Kërkesat e konfidencialitetit  
dhe
  - (b) Seksionit J.2.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme që përcakton të drejtat e Komitetit të Bursës për të propozuar modifikime në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat.

#### A.1.3 Modifikimet në Procedurë

- A.1.3.1 Kjo Procedurë mund të modifikohet vetëm në përputhje me Kapitujt J ose K të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.

#### A.1.4 Pajtueshmëria me Procedurat

- A.1.4.1 Kjo Procedurë është e detyrueshme për ALPEX-in, Komitetin e Bursës dhe çdo Anëtar të Bursës dhe e zbatueshme në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.
- A.1.4.2 Çdo Anëtar i Komitetit të Bursës me zgjedhjen ose emërimin e tij/saj do të firmosi një angazhim me shkrim për të respektuar këtë Procedurë dhe kërkesat e konfidencialitetit sipas seksionit B.2.7 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe do t'ia kthejë atë Sekretariatit të Komitetit të Bursës (roli i të cilit është parashikuar në seksionin I të kësaj Procedure). Vetëm pasi të ketë dorëzuar angazhimin me shkrim ky person do marrë atributet e anëtarit të Komitetit.

### **A.1.5 Roli i Autoriteteve Rregullatore**

A.1.5.1 Kjo Procedurë lejon përfshirjen e Autoriteteve Rregullatore në disa aspekte që lidhen me mbledhjet dhe vendimet e Komitetit të Bursës dhe ALPEX-it.

### **A.2 ANËTARËT E KOMITETIT NË FUNKSION TË PROMOVIMIT TË OBJEKTIVAVE**

A.2.1.1 Në kryerjen e detyrave të tyre sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Tregtimit, Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes dhe këtë Procedurë, çdo Anëtar i Komitetit të Bursës do të promovojojë objektivat e ALPEX-it, të përcaktuara në seksionin A.1.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.

A.2.1.2 Të gjithë anëtarët e Komitetit të Bursës duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionalisht dhe në mirëbesim për të realizuar objektivat e ALPEX-it siç përcaktohen në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, e mbështetur nga Parimet e ALPEX-it.

### **A.3 PËRMBLEDHJE E KËSAJ PROCEDURE**

#### **A.3.1 Përbajtja**

A.3.1.1 Kjo procedurë trajton:

- (a) Përbërjen e Komitetit të Bursës, duke përfshirë:
  - (i) Numrin e anëtarëve
  - (ii) Kategoritë e anëtarëve dhe vëzhguesve
  - (iii) Interesat për t'u përfaqësuar
  - (iv) Kualifikimet e anëtarëve
- (b) Mbledhjet e Komitetit të Bursës,
- (c) Fillimi i aktivitetit të Komitetit të Bursës,
- (d) Procedurat në vazhdim të Komitetit të Bursës, të cilat përfshijnë:
  - (i) Vendet vakante, emërimet dhe zgjedhjet e anëtarëve të Komitetit të Bursës
  - (ii) Termat dhe kushtet e emërimeve të anëtarëve të Komitetit të Bursës
  - (iii) Dorëheqja dhe largimi i anëtarëve të Komitetit të Bursës
- (e) Afatet kohore për konsultimet dhe propozimet e modifikimeve mbi Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.

#### **A.3.2 Përkufizimet**

A.3.2.1 Përkufizimet e përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Përkufizimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike kanë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Procedurë.

A.3.2.2 "Paraqitura e një Rekomandimi" nënkuption dorëzimin në mënyrë të përmbledhur të një rekomandimi që Sekretariati do ti dërgojë ALPEX-it ose Autoriteteve Rregullatore, sipas rastit, kur kërkohet sipas Kapitullit G i këtyre Procedurave.

---

## B. FORMAT E KËSHILLIMIT

---

### B.1 UDHËRRËFYESI

B.1.1.1 ALPEX-i mund të zhvillojë dhe publikojë udhërrëfyes për gjitha llojet e vendimeve, rekomandimeve dhe raporteve të Komitetit të Bursës, në lidhje me:

- a. Shqyrtimin e Modifikimeve të propozuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat (Kapitulli J i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme; Kapitulli F i kësaj Procedure),
- b. Zhvillimi i Rekomandimeve të paraqitura në ALPEX për Modifikimet e propozuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat, që paraqesin pikëpamjet e anëtarëve të Komitetit të Bursës (Kapitulli F i kësaj Procedure),
- c. Sugjerime për ALPEX-in që të merren këshilla të jashtme (seksioni G.3.8.3 i kësaj Procedure); dhe
- d. Vendimet nëse do të hiqet një anëtar në përputhje me seksionin A të kësaj Procedure.

---

## C. KOMITETI I BURSËS

---

### C.1 KËRKESAT PËR ANËTARËSIM

#### C.1.1 Numri i Anëtarëve

C.1.1.1 Përbërja e Komitetit të Bursës do të jetë siç përcaktohet në seksionin B.2.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme. Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme parashikojnë jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, ku 8 (tetë) anëtarë emërohen nga Anëtarët e Bursës dhe 2 (dy) anëtarë emërohen nga ALPEX.

#### C.1.2 Emërimet e kryetarit dhe zëvëndëskryetarit

C.1.2.1 Kryetari dhe zëvëndëskryetari i Komitetit të Bursës emërohen nga ALPEX-i në përputhje me seksionin B.2.4 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.

#### C.1.3 Kategoritë e anëtarëve dhe vëzhguesve

C.1.3.1 Në përputhje me seksionin B.2.3.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, një anëtar i Komitetit të Bursës mund të jetë ose:

- Njëri prej anëtarëve të propozuar nga Anëtarët e Bursës në përputhje me këtë Procedurë; ose
- Një prej dy anëtarëve të emëruar nga ALPEX-i.

C.1.3.2 Një vëzhgues i Komitetit të Bursës mund të jetë ose:

- Një vëzhgues normal, i emëruar nga Autoritetet Rregullatore në përputhje me seksionin B.2.3.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme; ose
- Një vëzhgues *ad hoc*, i autorizuar nga kryetari për të marrë pjesë në një mbledhje specifike në përputhje me seksionin D.2.2 të kësaj Procedure.

#### C.1.4 Larmishmëria e përfaqësimit të palëve të interesit

C.1.4.1 Anëtarët e Komitetit të Bursës do të kenë:

- Barazi përfaqësimi për aq sa është e mundur nga Anëtarët e Bursës të të dy zonave të ofertimit Shqipëri-Kosovë.
- Të paktën dy Anëtarë që kanë njojuri ose ekspertizë në rolin e Prodhuesve (siç përcaktohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e përgjithshme).
- Të paktën dy Anëtarë që kanë njojuri ose ekspertizë në rolin e Furnizuesit (siç përcaktohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme).
- Të paktën një Anëtar që përfaqëson Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
- Të paktën një Anëtar që përfaqëson Tregtarët.

#### C.1.5 Kualifikimi i anëtarëve

C.1.5.1 ALPEX dhe Anëtarët e Bursës duhet të sigurojnë që të propozuarit e tyre për Anëtarë të Komitetit të Bursës të kenë aftësitë, autoritetin dhe kapacitetin e nevojshëm për të përmbrushur rolin, të cilat përfshijnë:

- Njojuri dhe ekspertizë në tregjet e energjisë elektrike, duke përfshirë njojuritë për sektorë të veçantë nga të cilët kanë eksperiencën.

- b. Njohuri dhe të kuptuarit e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurat, dhe kuadrit ligjor dhe Rregulator Evropian, Shqiptar dhe/ose Kosovar.

#### C.1.6 Anëtarët do të veprojnë në ndihmë të arritjes së Objektivave të ALPEX-it

##### C.1.6.1 Pavarësisht:

- (a) Interesave të Anëtarit të Bursës i cili ka propozuar një Anëtar të Komitetit; dhe  
(b) Seksioneve C.1.4 dhe C.1.5 të kësaj Procedure,

Në zbatim të detyrave sipas Rregullave të Energjisë Elektrike-Kushtet e Përgjithshme dhe të Procedurave, çdo Anëtar i Komitetit duhet të veprojë gjatë gjithë kohës në përputhje me parashikimet e kësaj Procedure, në interesin më të mirë të përgjithshëm për ALPEX-in dhe në ndihmën për të arritur Objektivat e ALPEX-it të cilat mbështeten nga Parimet e ALPEX-it.

---

## D. MBLEDHJET E KOMITETIT TË BURSËS

---

### D.1 PLANIFIKIMI I MBLEDHJEVE

#### D.1.1 Frekuenca e mbledhjeve

D.1.1.1 Komiteti i Bursës do të mblidhet:

- a. Të paktën një herë në vit.
- b. Sa herë që kërkohet, bazuar në çështje konkrete nëse gjyket e përshtatshme nga Anëtarët e Komitetit të Bursës, (siç përcaktohet në paragafin B.2.5.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme).
- c. Kur ALPEX-i ose një kuorum prej tre anëtarësh të Komitetit të Bursës caktojnë një mbledhje në përputhje me nënseksionin B.2.5.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.
- d. Mbledhja drejtuhet nga Kryetari i Komitetit të Bursës dhe në mungesë të tij nga zëvendës Kryetari.

#### D.1.2 Njoftim i mbledhjeve

D.1.2.1 ALPEX-i do të:

- a. Publikojë datat e mbledhjeve të Komitetit të Bursës të paktën 10 ditë përpara. Një njoftim i tillë do të përfshijë:
  - i. Datën, orën dhe vendin.
  - ii. Një rend dite.

D.1.2.2 Përpara çdo mbledhje të Komitetit të Bursës:

- a. ALPEX do të njoftojë anëtarët për organizimin e mbledhjes.
- b. Sekretariati do t'u japë Anëtarëve të Komitetit të Bursës detajet e Propozimeve të Modifikimeve, siç përcaktohet në seksionin G.3.2.1 të kësaj Procedure, si dhe detajet e çështjeve të tjera.

### D.2 ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE

#### D.2.1 Kuorumi

D.2.1.1 Kuorumi për një mbledhje të Komitetit të Bursës është të paktën sa gjysma numrit të Anëtarëve të zgjedhur apo emëruar. Pa kuorumin e nevojshëm nuk mund të merret vendime nga Komiteti i Bursës.

D.2.1.2 Nëse një Anëtar i Komitetit të Bursës e ka të pamundur të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Bursës, këtij Anëtar mund ti jepen më përpara materialet që do trajtohen nga Komiteti i Bursës për aq sa është e mundur. Për më tepër, një anëtar tjetër mund të përfaqësojë këtë anëtar duke pasur të drejtë të votojë. Sekretaria duhet të informohet me shkrim në raste të tilla.

#### D.2.2 Pjesëmarrja e vëzhguesve

D.2.2.1 Në përputhje me paragafin B.2.5.4 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, çdo person mund të marrë pjesë në një mbledhje të Komitetit të Bursës si vëzhgues me kusht që:

- Personi e ka informuar kryetarin të paktën 8 (tetë) ditë përpara për kërkesën e tij për të marrë pjesë në mbledhje dhe natyrën e interesit të tij.
  - Personi ka dhënë çdo garanci të konfidencialitetit.
  - Personi ka dhënë në kohën e duhur çdo informacion shtesë ose garanci të kerkuar në mënyrë të arsyeshme nga kryetari; dhe
  - Kryetari ka konfirmuar me shkrim se personi mund të marrë pjesë në një mbledhje ose disa mbledhje të caktuara.
- D.2.2.2 Përveç vëzhguesve të emëruar nga Autoritetet Rregullatore, vëzhguesit nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutime ose debate, nëse ka, në mbledhje, përveç nëse është marrë miratimi me shkrim nga kryetari.
- D.2.2.3 Vëzhguesit nuk mund të votojnë në mbledhjet e Komitetit të Bursës.
- D.2.2.4 Kur hapësira për mbledhje është e kufizuar, pjesëmarrja e vëzhguesve mund të kufizohet në bazë të parimit “i pari në kohë, i pari në shërbime” (përveç vëzhguesve të caktuar nga Autoritetet Rregullatore të cilët mund të marrin pjesë gjithmonë në mbledhje).
- D.2.3 Vendimet dhe votimi**
- D.2.3.1 Vendimet do të miratohen me një shumicë të thjeshtë të votave të vlefshme. Në rast të votave të barabarta, votën vendimtare e jep drejtuesi i mbledhjes. Nëse drejtuesi abstenon nga votimi, votimi do të konsiderohet i refuzuar.
- D.2.3.2 Një Anëtar i Komitetit të Bursës mund të kërkojë një debat ose diskutim përpara votimit dhe kryetari duhet të pajtohet me një kërkesë të tillë kur është e arsyeshme dhe praktike.
- D.2.4 Procesverbali**
- D.2.4.1 Sekretariati do të përpilojë me shkrim procesverbalin dhe rezultatin e mbledhjes të Komitetit të Bursës, të nënshkruar nga drejtuesi i mbledhjes.

---

## E. PËRBËRJA E KOMITETIT TË BURSËS

---

### E.1 PËRBËRJA E KOMITETIT TË BURSËS

#### E.1.1 FILLIMI I KOMITETIT TË BURSËS

E.1.1.1 Autoriteti Rregullator mund të emërojë një vëzhgues i cili do të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Bursës duke i dërguar një kërkesë me shkrim ALPEX-it.

#### E.1.2 Anëtarët në fillimin e Komitetit të Bursës

E.1.2.1 Në mënyrë që ta ndihmojë tregun, në fillim Komiteti i Bursës të përbëhet nga:

- (a) Një minimum prej katër (4) anëtarësh të zgjedhur:
  - (i) Për të reflektuar larmishmërinë e Anëtarëve të Bursës siç parashikohet në seksionin C.1.4 të kësaj Procedure; dhe
  - (ii) Të përzgjedhur nga personat e propozuar me shkrim dhe drejtuar Sekretariatit prej Anëtarëve potencial të Bursës; dhe
  - (iii) Të zgjedhur për një periudhë fillore që nuk e kalon dy vite;
- (b) Të paktën dy anëtarë të tjera të cilët emërohen nga ALPEX, ku njëri prej tyre do të jetë Kryetari.

E.1.2.2 Afati i një emërim i bërë sipas paragrafit E.1.2.1(a) të kësaj Procedure mbaron sipas afateve të parashikuara ose kur emërimet jane bërë sipas kapitullit C të kësaj Procedure cilaqoftë e para.

E.1.2.3 Subjekt i paragrafit F.3.1.2 të kësaj Procedure, një anëtar i Komitetit të Bursës i emëruar sipas paragrafit E.1.2.1(a) të kësaj Procedure mund të ndiqet nga rizgjidhja sipas Kapitullit F të kësaj Procedure.

#### E.1.3 Koha për emërimet e rradhës

E.1.3.1 Në takimin e parë, Komiteti i Bursës do të vendosi lidhur me emërimet e Anëtarëve të Bursës sipas Kapitullit F të kësaj Procedure<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Seksoni K.1.4 i Rregullave të Tregut të Energjisë elektrike – Kushtet e Përgjihshme kërkon që emërimi fillostar i anëtarëve të Komitetit të Bursës të bëhet sipas kushteve që përfshijnë disa emërire për një mandat njëvjeçar dhe disa për një mandat dyvjeçar. Vendosja e datave të ndryshme të përfundimit të afatit ka për qëllim promovimin e vazhdimësisë së Komitetit të Bursës.

## F.

## AKTIVITETET E MËTEJSHME TË KOMITETIT TË BURSËS

### F.1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### F.1.1 Zbatimet i këtij Kapitulli

F.1.1.1 Pas krijimit të Komitetit të Bursës, nëse një pozicion Anëtari i Komitetit të Bursës mbetet vakant për ndonjë arsy, duke përfshirë çdo zgjedhje të përgjithshme të propozuar sipas Procedurave, atëherë procedurat në këtë Kapitull E do të zbatohen.

#### F.1.2 Administrimi i Zgjedhjeve të Komitetit

F.1.2.1 Sekretariati i krijuar nga ALPEX-i për të kryer detyrat e përcaktuara në Seksionin H të këtyre Procedurave, do të administrojë çdo zgjedhje të anëtarëve të Komitetit të Bursës.

#### F.1.3 Autoriteti për të bërë emërimet dhe zgjedhjet

F.1.3.1 Anëtarët e Bursës mund të propozojnë anëtarë të Komitetit të Bursës kur njoftohen nga Sekretariati.

F.1.3.2 Me përfundimin mandatit ose shkarkimin e ndonjë anëtari të Komitetit të Bursës që është i emëruar nga ALPEX-i, ai person do të zëvendësohet nga një i emëruar i ALPEX-it, i cili do të emërohet automatikisht në Komitetin e Bursës.

F.1.3.3 Çdo Autoritet Rregulator do të ketë të drejtë të zëvendësojë vëzhguesit e tyre përkatës të emëruar në çdo kohë duke njoftuar ALPEX-in dhe Komitetin e Bursës, me efekt nga data e specifikuar në këtë njoftim.

### F.2 PROCEDURAT ZGJEDHORE

#### F.2.1 Njoftimi i vendeve vakante

F.2.1.1 Të paktën 30 ditëpërpëra mbarimit të mandatit të ndonjë prej anëtarëve në Komitetin e Bursës, ose përpëra datës së zgjedhjeve të përcaktuara në paragrin E.1.3.1 të kësaj Procedure, Sekretariati do të:

- Njoftojë Anëtarët e Bursës për mbarimin e mandatit për anëtarin përkatës; dhe
- Nëse vendi vakant nuk është subjekt i emërimit nga ALPEX-i sipas seksionit C.2.2 të kësaj Procedure, do të përzgjidhen kandidaturat në përputhje me seksionin F.2.2 të kësaj Procedure.

F.2.1.2 Kur një anëtar i Komitetit të Bursës shkarkohet, del në pension ose jep dorëheqjen nga Komiteti i Bursës, Sekretariati brenda tridhjetë (30) ditëve do të:

- Njoftojë Anëtarët e Bursës për shkarkimin, daljen në pension ose dorëheqjen; dhe
- Ku vendi vakant:
  - Nuk i nënshtrohet emërimi nga ALPEX-i sipas seksionit F.1.3.2 të kësaj Procedure.
  - Kryetari i Komitetit të Bursës pajtohet se zgjedhjet janë të nevojshme dhe të garantuara;
  - Do të ftojë kandidatët për të plotësuar këtë vend vakant në përputhje me seksionin F.2.2 të kësaj Procedure.

F.2.1.3 ALPEX-i do të organizojë një procedurë zgjedhje për të plotësuar atë vend vakant në përputhje me hapat në seksionet F.2.3 dhe F.3 të kësaj Procedure.

F.2.1.4 Zgjedhjet do të zhvillohen, aty ku është e mundur, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së mbarimit të anëtarësimit të një ose më shumë prej anëtarëve të zgjedhur të Komitetit të Bursës pér të zëvendësuar këta persona në Komitetin e Bursës.

## F.2.2 Propozimet

F.2.2.1 Sekretariati do të sigurojë detaje të formës së aplikimit pér Anëtarët e Bursës. Këto propozime duhet të paktën të:

- bëhen me shkrim;
- nënshkruhen nga përfaqësuesi i autorizuar i Anëtarit të Bursës;
- të indentifikoj aftësitë dhe kualifikimet e aplikuesit ( referoju seksionit C.1.5.1 të kësaj Procedure) që do të ishte e lidhur me emërimin e tij/saj në Komitetin e Bursës;

F.2.2.2 Komiteti i Bursës mund të kërkojë kandidatë me aftësi ose kualifikime të veçanta, në mënyrë që të arrihet larmishmëria e përshkruar në seksionin C.1.4 të kësaj Procedure.

F.2.2.3 Çdo Anëtar i Bursës ka të drejtë të propozojë dy kandidatë sipas kategorive e përshkruar ne seksion C.1.4.

## F.2.3 Mënyra e perzgjedhjes së Anëtarit kur vendet e lira tejkalojnë propozimet

F.2.3.1 Nëse numri i propozimeve që plotësojnë kualifikimet pér të qënë anëtar i Komitetit të Bursës është më i vogël ose i barabartë me numrin e vendeve vakante, Sekretariati do të:

- Deklarojë këta të propozuar që janë të përzgjedhur me sukses si anëtarë të Komitetit të Bursës; dhe
- Në rast se nuk arrihet numri minimal i anëtarëve të Komitetit të Bursës, do të informojë anëtarët e Komitetit të Bursës duke i dhënë atyre pesë (5) ditë pune të propozojnë kandidatë dhe zëvendësues të rinj pér përzgjedhje në përputhje me paragrafin (a) më lart, ose me seksionin F.2.4 të kësaj Procedure, sipas rastit.

F.2.3.2 Nëse nuk ka aplikime të tjera, do të konsiderohet se Komiteti i Bursës e ka përmbushur detyrimin e tij sipas kësaj Procedure pér të krijuar Komitetin e Bursës dhe Komiteti i Bursës do të njoftojë anëtarët e Komitetit të Bursës se zgjedhjet kanë dështuar.

F.2.3.3 Pavarësisht se zgjedhja ka dështuar, të paktën 75% e anëtarëve të Komitetit të Bursës mund të kërkojnë nga Komiteti i Bursës që të kërkojë aplikime të tjera në lidhje me një vend vakant të paplotësuar të Komitetit të Bursës, brenda gjashtë (6) muajve pas datës së njoftimit të zgjedhjeve të dështuara. Komiteti i Bursës do të përmbushë këtë kërkesë.

## F.2.4 Zgjedhjet kur propozimet tejkalojnë vendet vakante.

F.2.4.1 Nëse numri i të propozuarve që plotësojnë kualifikimet pér anëtar të Komitetit të Bursës është më i madh se numri i vendeve vakante, Sekretariati do të përgatisë dhe shpërndajë anëtarëve të Komitetit të Bursës:

- Një fletë votimi ku renditen kandidatët sipas rendit alfabetik; dhe
- Një biografi pér çdo kandidat (të përgatitur nga kandidati), që permッシュ kriteret parashikuar në seksionin C.1.5 të kësaj Procedure.

F.2.4.2 Pér t'u konsideruar e vlefshme, fleta e votimit duhet të plotësohet sipas udhëzimit që shoqëron fletën e votimit dhe të depozitohet në Sekretariat:

- Deri në orën 16:30 të datës së përcaktuar;
- Personit të shënuar si personi i caktuar per marrjen e fletës së votimit ;
- Në adresën e shënuar si adresë e kthimit të fletës së votimit;

- d. Fleta e votimit mund të dërgohet në mënyrë elektronike në një adresë emaili të caktuar nga Sekretariati, në dakordësi të Komitetit të Bursës.
- F.2.4.3 Për të siguruar larmishmërinë e synuar të anëtarësimit, ALPEX mund të strukturojë fletën e votimit si vijon:
- a. Ta ndajë atë në kategoritë e renditura në seksionin C.1.4 të kësaj Procedure dhe të kërkojë të paktën një votë për një kandidat në secilën kategori; ose
  - b. Të kërkojë nga Anëtarët e Bursës të shpërndajnë votat e tyre ndërmjet kandidatëve dhe të mos vendosin të gjitha votat e tyre kundër emrit të një kandidati të preferuar.
- F.2.4.4 Çdo Anëtar i Bursës do të ketë të drejtën e një vote.
- F.2.4.5 Votimi nga çdo Anëtar i Bursës do të bëhet me anë të një shënim i në kuadratin bosh kundrejt emrit të kanditatëve.
- F.2.4.6 Nëse një fletë votimi përmban më shumë shënimë kundrejt emrave të kanditatëve sesa votat që mund të hidhen (më shumë se një shënim kundrejt një kandidati të vetëm) ose qëllimi i Anëtarit të Bursës është i paqartë, një votim i tillë do të nuk jetë i vlefshëm dhe nuk do të përfshihet në numërim.

## **F.2.5 Përcaktimi dhe publikimi i rezultateve**

- F.2.5.1 Sekretariati do të përcaktojë ata kandidatë që janë zgjedhur me sukses në Komitetin e Bursës si më poshtë (dhe sipas kësaj radhe):
- a. Kandidati që merr numrin më të madh të votave.
  - b. Kandidati që merr numrin e radhës më të madh të votave dhe kështu me rradhë derisa të plotësohen të gjitha vendet vakante.
  - c. Kur ka një numër të barabartë votash për dy (2) ose më shumë kandidatë, nëse ka vende të lira të mjaftueshme, secili nga këta kandidatë do të zgjidhet me përparësi ndaj një kandidati që ka marrë më pak vota. Nëse nuk ka vende të lira të mjaftueshme, Sekretariati do t'i vendosë emrat e akandidaëve që kanë marrë numër të barabartë votash në një vezë dhe do të térheqë rastësisht një emër dhe ai kandidati do të zgjidhet. Kjo procedurë do të përsëritet derisa të plotësohen të gjitha vendet e lira.
  - d. Kur pas votimit për të gjitha vendeve vakante, rezulton një numër i pamjaftueshëm anëtarësh që janë ose përfaqësojnë Prodhuesit, Furnizuesit, OST-të, Tregtarët, në përputhje me kërkeshat e seksionit C.1.4.1 të kësaj Procedure, Sekretariati do të caktojë kandidatin me numrin më të madh të votave të në kategorinë përkatëse i cili do të zgjidhet në vend të personit të fundit të zgjedhur nga votimi të mësipërme. Ky proces do të vazhdojë me rradhë derisa të ketë një numër të mjaftueshëm votash, të cilët janë ose përfaqësojnë secilen nga kategoritë përkatëse.
  - e. Kandidatët që janë votuar sipas dispozitive të mësipërme dhe që nuk janë zëvendësuar sipas pikës (d) të këtij seksioni F.2.5.1, konsiderohen të zgjidhur.
- F.2.5.2 Sekretariati do të publikojë rezultatet e zgjedhjeve brenda pesë (5) ditëve të punës nga numërimi në seksionin F.2.5.1 të kësaj Procedure.
- F.2.5.3 Nëse për çfarëdo arsy, kjo Procedurë nuk rezultojnë në diversitetin e interesave të përcaktuara në seksionin C.1.4 të këtyre Procedurave, ALPEX mund të emërojë anëtarë shtesë.

### **F.3 AFATI I EMËRIMIT**

- F.3.1.1 Çdo anëtar i Komitetit të Bursës do të emërohet për një mandat maksimal prej dy vitesh, me kusht që, në rastet kur janë bërë zgjedhje *ad hoc* për të plotësuar një vend vakant, për shkak se një anëtarë është shkarkuar, ka dalë në pension ose ka dhënë dorëheqjen nga Komiteti i Bursës, anëtarë i sapozgjedhur do të emërohet në parim për një mandat maksimal prej një viti dhe ky mandat do të përfundojë në përputhje me datën vjetore të zgjedhjeve që është më afér datës së skadimit të mandatit.
- F.3.1.2 Anëtarët që kanë shërbyer më parë në Komitetin e Bursës mund të riemërohen ose të rizgjidhen në Komitetin e Bursës me kusht që ata të mos jenë shkarkuar në asnjë moment nga Komiteti i Bursës ose të pushojnë së qëni të kualifikuar në përputhje me seksionin C.3.2 të këtyre Procedurave.
- F.3.1.3 Anëtarësimi i Komitetit të Bursës do të përfundojë automatikisht në fund të mandatit të një anëtarë, përvèç nëse përfundimi i tillë do ta linte Komitetin e Bursës me më pak se katër (4) anëtarë, në të cilin rast mandati i anëtarësimit mund të zgjatet derisa një anëtar zëvendësues të emërohet ose zgjidhet në Komitetin e Bursës.

### **F.4 DORËHEQJA DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KOMITETIT TË BURSËS**

#### **F.4.1 Shkarkimi nga Komiteti i Bursës**

- F.4.1.1 Çdo anëtar i Komitetit të Bursës mund të shkarkohet gjatë mandatit të tij ose të saj me vendim të shumicës së Komitetit të Bursës nëse ai person:
- a. nuk është më në gjëndje të përfaqësojë pjesëmarrësit e Prodhuesëve, pjesëmarrësit e Furnizuesëve, OST-të ose pjesëmarrësit Tregtarë nga të cilët është propozuar anëtar;
  - b. bëhet i paaftë për të kryer funksionet e anëtarit të Komitetit të Bursës;
  - c. ka qenë ose është, sipas mendimit të arsyeshëm të shumicës së anëtarëve të tjerë të Komitetit të Bursës, i përfshirë në sjellje që nuk përputhet ose është e dëmshme për cilësinë si anëtar i Komitetit të Bursës; ose
  - d. Nuk përmbush detyrimet e një anëtarë të Komitetit të Bursës, duke përfshirë edhe mospjesëmarjen e përsëritur në mbledhje.

#### **F.4.2 DORËHEQJA**

- F.4.2.1 Një anëtar mund të japë dorëheqjen duke i dhënë të paktën dy javë përpara njoftim me shkrim kryetarit të Komitetit të Bursës.

---

## **G. PROCEDURAT E PROPOZIMEVE PËR MODIFIKIM**

---

### **G.1 HISTORIKU**

#### **G.1.1 BURIMET E PROPOZIMEVE PËR MODIFIKIM**

- G.1.1.1 Sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme sipas seksionit J.2.1, çdo Palë në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, vetë Komiteti i Bursës, Autoritetet Rregullatore ose ALPEX-i mund të propozojë një modifikim të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurat, në formën e një propozimi për Modifikim, të publikuar nga ALPEX.

#### **G.1.2 QËLLIMI I KËTIJ KAPITULLI**

- G.1.2.1 Pas shqyrtimit fillestar, sqarimit dhe vlerësimit të një propozimi për Modifikim, Rregullat të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme kërkojnë që ALPEX-i të konsultohet me Komitetin e Bursës për të gjitha propozimet për Modifikim që do të procesohen<sup>2</sup>
- G.1.2.2 Për qëllimet e këtij konsultimi, ky Kapitull përcakton parimet që duhen zbatuar nga Komiteti i Bursës, rezultatet e kërkua nga Komiteti i Bursës, informacionin dhe afatet kohore për ALPEX-in dhe Komitetin e Bursës në lidhje me propozimet për Modifikim të krijuara nga persona të ndryshëm nga Komiteti i Bursës.

#### **G.1.3 PROPOZIMET E MODIFIKIMIT TË INICIUARA NGA KOMITETI I BURSËS**

- G.1.3.1 Kur vetë Komiteti i Bursës fillon një propozim për Modifikim (dhe ofron një raport mbështetës), atëherë konsultimi i kërkuar nga Komiteti i Bursës sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme do të konsiderohet se ka ndodhur dhe ALPEX-i mund të marrë një vendim sipas nenit J.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.

### **G.2 PARIMET/QASJA**

#### **G.2.1 KËSHILLA NË KOHË**

- G.2.1.1 Nuk është e nevojshme që Komiteti i Bursës të arrijë një konsensus mbi këshillat. Megjithatë, është e rëndësishme që Komiteti i Bursës të konsiderojë në një afat kohor të arsyeshëm dhe me saktësi pikëpamjet e anëtarëve të tij, për të ofruar reagime në kohë dhe efektive për ALPEX-in sipas parashikimeve të seksionit J të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.

#### **G.2.2 PARAQITJA ME SAKTËSI E PIKËPAMJEVE**

- G.2.2.1 Në përgatitjen e paraqitjeve të rekandimeve për ALPEX-in, Komiteti i Bursës do të identifikojë çdo opinion të ndryshëm të Anëtarëve të Komitetit të Bursës.

---

<sup>2</sup> Referuar Seksionit J.2.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.

### **G.3 AFATET KOHORE PËR KONSIDERIMIN E PROPOZIMEVE PËR MODIFIKIM**

#### **G.3.1 HAPAT PARAPRAK NGA ALPEX-I**

G.3.1.1 Përpara paraqitjes së propozimeve për modifikim në mbledhjet e Komitetit të Bursës, ALPEX-i do të:

- a. Shqyrtojë dhe vlerësojë çdo propozim për Modifikim kundrejt Objektivit dhe Parimeve të ALPEX-it sa më shpejt të jetë e mundur;
- b. Nëse propozimi për modifikim është i parregullt, në kundërshtim me aktet ligjore dhe rregullatore, do të njoftojë propozuesin e tij dhe refuzojë propozimin për Modifikim;
- c. Vendosë nëse do ta modifikojë propozimin për Modifikim apo ta kombinojë atë me një tjetër; dhe
- d. Kërkojë informacion shtesë nga propozuesi, nëse e vlerëson të nevojshme.

#### **G.3.2 NJOFTIMI I PROPOZIMEVE PËR MODIFIKIM**

G.3.2.1 ALPEX-i do të sigurojë për çdo mbledhje të Komitetit të Bursës:

- a. Në lidhje me çdo propozim të ri për modifikim që është gati për t'iu referuar Komitetit të Bursës për shqyrtim:
  - i. Detajet e plota të Propozimeve për Modifikim;
  - ii. Vlerësimin fillestar të ALPEX-it kundrejt objektivit dhe parimeve të ALPEX-it;
  - iii. Një draft të tekstit të Propozimeve për Modifikim;
  - iv. Informacionin e disponueshëm; dhe
  - v. Çdo pyetje specifike, kontribut ose udhëzim që ALPEX-i kërkon nga Komiteti i Bursës;
- b. Detajet e statusit të të gjitha Propozimeve aktive për Modifikim;
- c. Detajet e çdo Propozimi për Modifikim të refuzuar si i parregullt, dhe arsyetimin për atë vlerësim.

G.3.2.2 Detajet e dhëna në seksionin G.3.2.1(b) të këtyre Procedurave do të përfshijnë:

- a. një listë me Propozime për Modifikim që ALPEX-i ka marrë që nga mbledhja e mëparshme e Komitetit të Bursës;
- b. Detajet e çdo Propozimi për Modifikim në lidhje me të cilin propozuesi ka kërkuar shqyrtim urgjent;
- c. Detajet se si ALPEX-i i është përgjigjur ose propozon t'i qaset Propozimi për Modifikim që nuk i është referuar ende Komitetit të Bursës për konsultim; dhe
- d. Kur ALPEX-i ka modifikuar ose kombinuar Propozime për Modifikim, detajet e ndryshimeve të bëra dhe arsyetimin përkatës.

#### **G.3.3 PROPOZIMET URGJENTE PËR MODIFIKIM**

G.3.3.1 ALPEX-i, sa më shpejt që të jetë e mundur, me marrjen e një Propozimi për Modifikim i cili shënohet "Urgjent", do të përcaktojë nëse do të trajtohet apo jo si urgjent.

G.3.3.2 Një Propozim për Modifikim do të përcaktohet si urgjent nga ALPEX kur-i, sipas vlerësimit të tij:

- a. Parashikohet në mënyrë të arsyeshme që ngjarja ose rrethanat me të cilat ka të bëjë Propozimi për Modifikim do të ndërhyjnë në mënyrë të menjëhershme, do të prishin ose do të kërcenojnë funksionimin efikas të ALPEX-it; ose
- b. Propozimi për Modifikim kërkohet të korrigojë:

- i. Një gabim material ose mospërputhje në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme ose Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat.
  - ii. Një konflikt midis dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe një ose më shumë kërkesave Ligjore.
- G.3.3.3 Nëse ALPEX-i konsideron se një Propozim për Modifikim është urgjent sipas seksionit G.3.3.2 të këtyre Procedurave, ai do të caktojë një mbledhje ose mbledhje shtesë të Komitetit të Bursës në përputhje me seksionin B.2.5.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike- Kushtet e përgjithshme.

#### **G.3.4 PROCESI I PËRSHPETJUAR PËR NDRYSHIME TË THJESHTA**

- G.3.4.1 ALPEX-i mund t'i sqarojë Komitetit të Bursës se një Propozim për Modifikim është i një natyre të vogël ose rutinë, dhe si rrjedhojë ALPEX-i konsideron se ky ndryshim mund të bëhet me anë të procesit të përshpetjtar. Shembuj të tillë janë ndryshime në:
- a. Korrigimin e gabimeve në formatim, numërim ose shtypje;
  - b. Përditësimin e referencave;
  - c. Shtimin e kutive me tekst ose shembujve shpjegues;
  - d. Zbatimin e ndryshimeve të vogla që konsiderohen të mundshme për t'u pranuar ose janë të dëshiruara gjérësisht nga Anëtarët e Bursës;

- G.3.4.2 Komiteti i Bursës mund të shqyrtojë dhe votojë Propozimet për Modifikim të identifikuara në seksionin G.3.4.1 të këtyre Procedurave, pa ndjekur procedurat e përcaktuara në seksionet G.3.5 deri në G.3.9 të këtyre Procedurave.

#### **G.3.5 PROCEDURA PËR ZHVILLIMIN E REKOMANDIMEVE DHE RAPORTEVE**

- G.3.5.1 ALPEX-i mund të publikojë në faqen zyrtare të internetit dorëzimin e rekondimeve sipas rastit. Propozimet për Modifikime mund të janë konfidenciale dhe si rrjedhojë ALPEX-i këto të dhëna konfidenciale nuk do ti publikojë në faqen zyrtare të internetit.

#### **G.3.6 AFATI KOHOR I RAPORTIMIT**

- G.3.6.1 Me përashtim të rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe, Komiteti i Bursës, i ndihmuar nga Sekretariati do të paraqesë një Rekomandim në lidhje me çdo propozim për Modifikim, i cili do t'i paraqitet ALPEX-it për vendim dhe Autoriteteve Rregullatore aty ku është e aplikueshme.
- G.3.6.2 Raporti do të dorëzohet në ALPEX brenda:
- a. 60 ditë pas marrjes së një propozimi për Modifikimi nga Komiteti i Bursës;
  - b. Një datë tjeter siç bien dakord ALPEX-i dhe Komiteti i Bursës, (Data e Raportimit).
- G.3.6.3 Kur ka një pamje të qartë nga Komiteti i Bursës, atëherë dorëzimi i Rekomandimit mund të japë pikëpamjet e Komitetit të Bursës:
- a. Nëse Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat do të janë në përputhje me Objektivat dhe Parimet e ALPEX-it (parakusht për ndryshimet sipas seksionit J.4.2.1(a) të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme).
  - b. Si do të ndikonin Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat në sektorë të ndryshëm.

- c. Si do të ndikonin Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat për lojtarët e vegjël kundrejt të mëdhenjve.
- G.3.6.4 Megjithatë, kur nuk ka konsensus brenda kornizës kohore, atëherë Sekretariati duhet të ofrojë një Rekomandim, i cili do të:
- a. Përbledhë pikëpamjet e anëtarëve të Komitetit të Bursës që mbështesin ose kundërshtojnë propozimin për Modifikim;
  - b. Sugjerojë çdo ndryshim që do të rriste mbështetjen ndaj propozimit për Modifikim;
  - c. Tregojë çdo analizë ose veprim të mëtejshëm nga ALPEX-i që rekomandohet nga Komiteti i Bursës.
- G.3.6.5 Në përgatitjen e Rekomandimit, Komiteti i Bursës dhe Sekretariati do të kenë parasysh natyrën potencialisht të ndjeshme tregtare të pikëpamjeve të Komitetit të Bursës. Për këtë arsy, dorëzimi i Rekomandimit do të jetë në format standard të ofruar nga ALPEX-i në faqen e tij të internetit.
- G.3.6.6 Pas marrjes së një propozimi për Modifikim nga ALPEX-i, Komiteti i Bursës do të shqyrtojë propozimin për Modifikim në mbledhjen e ardhshme.
- G.3.6.7 ALPEX-i ose kryetari mund të ftojë propozuesin e një propozimi për Modifikimi ose përfaqësuesin e tij për të parashtruar propozimin për Modifikim në mbledhjen e Komitetit të Bursës në të cilin ai do të shqyrtohet fillimisht.
- G.3.6.8 Në mbledhjen e Komitetit të Bursës, ku fillimisht shqyrtohet një Propozim për Modifikim, kryetari i Komitetit të Bursës duhet të:
- a. Shënojë datën e raportimit të caktuar në përputhje me seksionin G.3.6.2 të këtyre Procedurave.
  - b. Bëjë një vlerësim fillestar të rëndësisë, urgjencës dhe ndikimeve të mundshme të ndryshimeve të propozuara.
- G.3.6.9 Komiteti i Bursës do të bjerë dakord për një afat kohor dhe një qasje për të shqyrtuar dorëzimin e rekomandimit.

### **G.3.7 PROPOZIMET ALTERNATIVE**

- G.3.7.1 Çdo anëtar i Komitetit të Bursës që nuk mbështet një propozim për Modifikim që është në shqyrtim mund të propozojë një propozim për modifikim alternativ, i cili nëse jepet në kohë të mjaftueshme për t'u shqyrtuar brenda afatit kohor original të Komitetit të Bursës për të shqyrtuar propozimin fillestar për Modifikim, mund të konsiderohet në lidhje me, ose në zëvendësim të propozimit fillestar të Modifikimit.

### **G.3.8 SHQYRTIMI DHE VOTIMI I KOMITETIT TË BURSËS MBI PROPOZIMET PËR MODIFIKIMIT**

- G.3.8.1 Gjatë shqyrtimit nëse do të mbështesin një propozim për Modifikimi, anëtarët e Komitetit të Bursës mund të shprehin pikëpamjet mbi:
- a. Përputhjen me Objektivat dhe Parimet e ALPEX-it, mbështetëse të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat; dhe
  - b. Ndjimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme ose Procedurat tek Anëtarët e ndryshëm të Bursës.
- G.3.8.2 Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, çdo anëtar i Komitetit të Bursës do të përballojë kostot e veta, siç përcaktohet në seksionin B.2.6 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.

- G.3.8.3 Në përgjithësi, Komiteti i Bursës do të bazohet në ekspertizën dhe burimet e anëtarëve të tij për të shqyrtuar dhe vlerësuar Propozimet për Modifikim. Komiteti i Bursës mund:
- Të sigurojë këshilla të jashtme, me koston e anëtarëve të tij, në varësi të kërkeseve konfidenciale të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe këtyre Procedurave; ose
  - Tí sugjerojë ALPEX-it që ALPEX-i;
    - Të sigurojë vetë këshilla të jashtme të një natyre të caktuar; ose
    - Të bie dakord të paguajë kostot që lidhen me këshillat e jashtme të ofruara për Komitetin e Bursës.
- G.3.8.4 Komiteti i Bursës do të kërkojë një votim nga anëtarët e tij, nëse çdo propozim për Modifikim mbështetet apo jo nga secili anëtar i Komitetit të Bursës, rezultat i të cilit do të pasqyrohet në parashtrimin e Rekomandimit për ALPEX-in në përputhje me seksionin F.3.9 të këtyre Procedurave.
- G.3.8.5 Votimi mund të kryhet me ngritjen e dorës në një mbledhje, ose siç mund të dakordësohet ndryshe nga Komiteti i Bursës dhe ALPEX-i.

### **G.3.9 RAPORTIMI**

- G.3.9.1 Në datën e raportimit ose përpara datës së raportimit për një propozim për Modifikim, Komiteti i Bursës do të njoftojë me shkrim ALPEX-in për rezultatet e shqyrtimit të propozimit për Modifikim.
- G.3.9.2 Kur është marrë një votim i kërkuar sipas seksionit F.3.8.4 të këtyre Procedurave, Komiteti i Bursës do t'i raportojë ALPEX-it se propozimi për Modifikim është:
- Mbështetur nga Komiteti i Bursës, nëse shumica e anëtarëve të Komitetit të Bursës mbështesin zbatimin e propozimit për Modifikim; ose
  - Nuk mbështetet nga Komiteti i Bursës nëse shumica e anëtarëve të Komitetit të Bursës nuk e mbështesin zbatimin e propozimit për Modifikim.
- G.3.9.3 Dorëzimi i Rekomandimit sipas seksionit G.3.9.2 të këtyre Procedurave do të përfshijë një përbledhje të çdo opinioni kundërshtues të anëtarëve të Komitetit të Bursës.

### **G.4 VENDIM I ALPEX**

- G.4.1.1 Pas marrjes së rekomandimit nga Komiteti i Bursës, ALPEX-i do të vendosë se cilin nga opsonet në seksionin J.3.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme do të ndjekë.
- G.4.1.2 ALPEX-i do të marrë vendimin e tij sa më shpejt që të jetë e mundur praktikisht pas marrjes së Rekomandimit të Komitetit të Bursës.

---

## H. NJOFTIMET

---

### H.1 NJOFTIMET E KOMITETIT TË BURSËS

- H.1.1.1 Çdo formular propozimi ose fletë votimi e lëshuar nga Sekretariati do të japë detajet e datës së dorëzimit dhe personit të cilin duhet t'i kthehet formulari i propozimit ose fleta e votimit, duke përfshirë:
- Emrin;
  - Pozicionin; dhe
  - Detajet e kontaktit (përfshirë numrin e telefonit fiks dhe celular, numrin e faksit, postën dhe adresën e emailit).
- H.1.1.2 Data e dorëzimit për formularin e propozimit do të jetë një datë e cila nuk është më shumë se tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të formularit të propozimit nga Komiteti i Bursës.
- H.1.1.3 Data e dorëzimit të fletës së votimit do të jetë një datë e cila është së paku katërmëbëdhjetë (14) ditë nga data e dërgimit të fletës së votimit nga Komiteti i Bursës.

### H.2 PËRFAQËSUESI I ANËTARIT TË BURSËS

- H.2.1.1 Në lëshimin e njoftimeve për Anëtarët e Bursës sipas këtyre Procedurave, Sekretariati do të kontaktojë personin e caktuar nga një Anëtar i Bursës si kontaktin e tij, duke përdorur detajet e dhëna nga Anëtar i Bursës (Kontakti i Anëtarësimit). Kontakti i anëtarësimit mund të jetë ose:
- Personi i caktuar dhe detajet e dhëna ALPEX-it gjatë procesit të pranimit sipas Kapitullit C të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e Përgjithshme; ose
  - Një person dhe detaje të njoftuara më pas zyrtarisht nga Anëtar i Bursës në ALPEX, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.
- H.2.1.2 Sekretariati do të konsiderohet se ka përbushur çdo detyrim në lidhje me dërgimin e njoftimeve të përcaktuara në këto Procedura kur i dërgon një njoftim Kontaktit të Anëtarësimit. Nëse një Anëtar i Bursës nuk ka përbushur detyrimin e tij për të mbajtur të përditësuar detajet e tij të kontaktit, Sekretariati nuk do të jetë përgjegjës që ai Anëtar i Bursës nuk është në dijeni të një njoftimi.

### H.3 DËRGIMI I NJOFTIMEVE

- H.3.1.1 Një njoftim i Sekretariatit i kërkuar sipas kësaj Procedurave mund t'i jepet një Anëtar i Bursës me cilindo nga mjetet e listuara më poshtë:
- Kur i është dhënë personalisht kontaktit të anëtarësimit;
  - Kur është dërguar më postë drejtuar adresës të Kontaktit të Anëtarësimit; ose
  - Kur është dërguar me postë elektronike në adresën e postës elektronike (email) të Kontaktit të Anëtarësimit.
- H.3.1.2 Çdo njoftim që i është dërguar personalisht Kontaktit të Anëtarësimit, konsiderohet se është dërguar në momentin kur është dorëzuar.
- H.3.1.3 Çdo njoftim i dërguar me postë konsiderohet se është dorëzuar dyzet e tetë (48) orë pas postimit të zarfit që përmban njoftimin; dhe në dërgimin e provës, mjafton të vërtetohet se zarfi që përmban njoftimin është adresuar dhe postuar siç duhet.

H.3.1.4 Çdo njoftim i dërguar Kontaktit të Anëtarësimit me postë elektronike konsiderohet se i është dorëzuar kur dërgohet posta elektronike, me kusht që dërguesi të mos ketë marrë njoftim elektronik se posta elektronike nuk ishte e dorëzuar ose përndryshe nuk është dorëzuar me sukses tek marrësi i synuar.

---

## I. SEKRETARIATI

---

### I.1 DETYRAT

- I.1.1.1 ALPEX sh.a do të caktojë Sekretariatin dhe do ta njoftojë Komitetin.
- I.1.1.2 Sekretariati do të mbajë listën e anëtarëve të Komitetit të Bursës që përfshin emrin, shoqerinë, adresën e biznesit, numrin e telefonit (duke përfshirë një numër celular për të lehtesuar propozimet për modifikime urgjente) dhe adresën e postës elektronike për të gjithë anëtarët e Komitetit të Bursës.
- I.1.1.3 Sekretariati do të mirëmbajë faqen e internetit, duke e përditësuar atë brenda dhjetë (10) ditëve nga momenti i disponimit të materialit të ri përkatës. Informacioni i mëposhtëm mund të përfshihet në faqen e internetit:
- Informacioni përkatës në lidhje me propozimet për Modifikim, për sa kohë që ky informacion nuk është informacion tregtar i ndjeshëm apo kur ky informacion është subjekt i dispozitave të konfidentialitetit të përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike- Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, si dhe në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatore përkatëse;
  - Të gjitha axhendat e mbledhjeve dhe procesverbalet përbledhëse të nivelit të lartë të cilat miratohen nga kryetari i Komitetit të Bursës përpara publikimit në faqen e internetit;
  - orarin e mbledhjeve të publikuara në fillim të vitit dhe kohën dhe vendndodhjen e çdo mbledhje të re, nëse ka, sipas rastit.
- I.1.1.4 Sekretariati përgatit një axhendë për çdo mbledhje që do të përfshijë:
- Përditësimet e statusit për çdo propozim për modifikim.
  - Përditësimet e statusit për dorëzimet e rekomandimeve, nëse ka.
  - Përditësim mbi zbatimin.
  - Çdo detyrë tjetër; dhe
  - Çdo pikë e rendit të ditës që mund të gjenerohet nga një person tjetër përvèç Sekretariatit, mund t'i jepet Sekretariatit deri në të njëjtën ditë pune apo brenda asaj dite pune të nxjerrjes së rendit të ditës për atë mbledhje.
- I.1.1.5 Sekretariati do të sigurojë që të gjithë anëtarët e Komitetit të Bursës dhe vëzhguesit pjesëmarrës të nënshkruajnë marrëveshjen në lidhje me konfidentialitetin siç kërkohet sipas këtyre Procedurave.
- I.1.1.6 Sekretariati është gjithashtu përgjegjës për:
- Menaxhimin e ecurisë së propozimeve për Modifikim, ku përgjegjës për zhvillimin e plotë të propozimeve për Modifikim është Komiteti i Bursës. Komiteti i Bursës ka për detyrë të shqyrtojë dhe të vazhdojë progresin e propozimit për Modifikim.
  - Përgatitja e dorëzimeve të Rekomandimeve për çdo Modifikim aty ku është e përshtatshme, me të dhëna nga anëtarët e Komitetit të Bursës.
  - Kur një propozim për Modifikim është konsideruar nga Autoritetet Rregullatore ose nga ALPEX-i si propozim i cili kërkon punë të mëtejshme, Sekretariati, bazuar në vendimin dhe në kontributin e Komitetit të Bursës, do të ndajë përgjegjësitë dhe do të ndjekë ecurinë e kësaj pune.
- I.1.1.7 Sekretariati do të mbajë të gjitha procesverbalet të cilat do të janë procesverbale përbledhëse të nivelit të lartë në të gjitha mbledhjet dhe do të:
- qarkullojë procesverbalet përbledhëse të nivelit të lartë tek anëtarët brenda dhjetë (10) Ditëve të një mbledhjeje të zakonshme ose të Mbledhjes së Jashtëzakonshme, dhe

brenda pesë (5) Ditëve të një Mbledhjeje Emergjente. Këto procesverbale përbledhës të nivitet të lartë miratohen nga kryetari i Komitetit të Bursës.

## I.2 MBLEDHJET

- I.2.1.1 Mbledhjet do të mbahen sipas planit fiks vjetor, të paktën një herë në vit ose siç është rënë dakord ndryshe nga Komiteti i Bursës. Nëse nuk ka pikë të propozuara të rendit të ditës, mbledhja e planifikuar mund të anulohet me marrëveshje të Komitetit të Bursës.
- I.2.1.2 Mbledhjet shtesë ose të jashtëzakonshme mund të thirren siç specifikohet në Seksionin G.3.3.3 të këtyre Procedurave dhe seksionin B.2.5.1 dhe B.2.5.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.
- I.2.1.3 Mbledhjet urgjente do të kufizohen në diskutimin e Propozimit urgjent përkatës për Modifikim. Nëse nuk ka propozime për modifikime në diskutim, një mbledhje mund të anulohet.
- I.2.1.4 Mbledhjet e urgjencës thirren pasi të jetë bërë një Propozim Urgjent për Modifikim dhe të konsiderohet si Urgjent nga ALPEX-i.
- I.2.1.5 Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren:
  - a. Nga kryetari i Komitetit të Bursës, ose
  - b. Me një njoftim të dërguar me postë nga të paktën katër anëtarë të Komitetit të Bursës, ose
  - c. Me marrëveshje në një mbledhje të zakonshme.